



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 8356/prot.

Shkodër, më 22.05. 2025

Lënda: *Kthim përgjigjeje shkresës nr.8356 prot., datë 23.04.2025*

Z. HERIBERT PALUSHANI

(Adresa: Rruga: "Kardinal Mikel Koliqi", Shkodër; Cel:0672173113).

I nderuar, Z. Palushani,

Të nderuar qytetarë dhe përfaqësues të grupit nismëtar,

Në përgjigje të peticionit tuaj të protokolluar me nr. 8356, datë 23.04.2025, lidhur me kërkesën për ndryshimin e nenit 37 të projekt-vendimit "Për miratimin e rregullores për përdorimin e hapësirës publike në Bashkinë Shkodër", ju informojmë sa vijon:

Më datë 22.04.2025, keni dorëzuar kërkesën tuaj fillestare përmes postës elektronike dhe njëkohësisht e keni depozituar me shkrim pranë Zyrës së Protokoll-Arkivit të Bashkisë Shkodër, e regjistruar me nr.8219 prot., datë 22.04.2025. Po ashtu, më datë 23.04.2025, është paraqitur nga ana juaj peticioni përkatës, i regjistruar me nr. protokolli 8356.

Po atë ditë, më datë 23.04.2025, është zhvilluar seanca e konsultimit publik në lidhje me projekt-vendimin: "Për miratimin e rregullores së përdorimit të hapësirave publike në Bashkinë Shkodër, në të cilën morët pjesë dhe paraqitët propozimet tuaja.

Kërkesa/peticioni juaj është pranuar dhe protokolluar në përputhje me procedurat përkatëse, dhe është përcjellë menjëherë për shqyrtim te strukturat përgjegjëse. Bazuar në nenin 19/1 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe në respekt të së drejtës kushtetuese për pjesëmarrje në vendimmarrje, kërkesa juaj është konsideruar legjitime dhe është marrë në shqyrtim.

Kërkesa për ndryshimin e nenit është përcjellë pranë administratës së Bashkisë Shkodër, si hartuese e projekt-aktit, për të paraqitur një relacion shtesë mbi përmbajtjen dhe qëllimin e këtij neni. Këshilli Bashkiak do të shqyrtojë kërkesën tuaj gjatë seancës ku do të vendoset për miratimin ose modifikimin e projekt-vendimit në tërësi ose në pjesë të caktuara të tij.

Ju garantojmë se Këshilli Bashkiak angazhohet për një trajtim të drejtë , transparent dhe të paanshëm të çdo kërkesë, duke u mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi dhe në interesin më të mirë të komunitetit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KRYETAR

